

KOMUNIKIM PËR MEDIAT

Data: 26 Maj 2014

Shqipëria në Bienalen e Venecias.

Kuratorë të pavijonit shqiptar Beyond Entropy Europe, fitues të Luanit të Artë në edicionin e kaluar te artit.

Republika e Shqipërisë merr pjesë në edicionin e 14-të të Ekspozitës Ndërkombëtare të Arkitekturës në Bienalen e Venecias, në pavijonin e titulluar:

Potential Monuments of Unrealised Futures
(Monumente të Mundshëm Ardhmërisht të Perealizuar)

ku do të prezantohen punët e dy artistëve shqiptarë:
“Penthouse” (Shtesat), një seri pikturash nga Edi Hila
dhe “The Column “ (Kolona), video/instalacioni nga Adrian Paci.

Pavijoni i Shqipërisë, kurohet nga Beyond Entropy Europe (Jonida Turani, Stefano Rabolli Pansera), ideatorë të pavijonit të Angolës në Bienalen e Artit, Venecia 2013, që u shpall dhe fitues i “Luanit të Artë” si përfaqësimi më i mirë kombëtar

Mbikqyret nga Ministria e Kultures e Shqipërisë dhe realizohet nga Ministria Kulturës së Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave, me mbështetjen e artistëve pjesëmarrës, galerive të tyre dhe koleksionistëve e donatorëve privatë.

Shqipëria përfaqësohet në edicionin e 14-të të Bienales me dy artistët Adrian Paci dhe Edi Hila, me temën “Potential Monuments of Unrealised Futures” (**Monumente të Mundshëm Ardhmërisht të Perealizuara**) që kurohet nga Beyond Entropy Europe (përfaqësuar nga Jonida Turani, Stefano Rabolli Pansera), ideatorë të pavijonit të Angolës Bienalen e shkuar, që u shpall dhe fitues i “Luanit të Artë” si përfaqësimi më i mirë kombëtar.

Beyond Entropy propozoi që Shqipëria të përfaqësohej me dy artistë, dhe jo arkitektë, në Bienalen e Arkitekturës në Venecia – një interpretim mjaft i gjetur i temës së kësaj ekspozite përcaktuar nga kuratori i saj, Rem Koolhaas, “Absorbing Modernity: 1914 – 2014” (“Absorbimi i Modernitetit: 1914 – 2014”), i cili ishte shprehur qartazi se: *“Fundamentals”* (titulli i ekspozitës që do të kurohet prej tij) *do të jetë një bienale që do t'i kushtojë arkitekturës dhe jo arkitektëve.*

Nëpërmjet hulumtimit të tyre artistik Edi Hila dhe Adrian Paci ofrojnë një mënyrë të re për të lexuar shtigjet e ndërprera të modernitetit në Shqipëri. Pavijoni shqiptar eksploron se si është përthithur arkitektura falë një reflektimi mbi dinamikën socio-kulturore të modernizmit, element thelbësor ky në punën e të dy artistëve. Ardhmëritë e perealizuara janë premtimet e modernitetit, pjesërisht të realizuara, por asnjëherë të përfunduara. Artistët ftojnë vizitorët të ndërthurin referenca reale dhe referenca të ndërtuara, të kaluara dhe të sotme, tregime imagjinare dhe lexime formale të qytetit përtej gjuhës tradicionale të përfaqësimit arkitektonik. Duke ndalur vështrimin në hapësirat e mbetura, në proceset e ndërtimit dhe të elementeve të papërfunduara, ata ndryshojnë këndvështrimin e arkitekturës tradicionale. Planet e fragmentuar dhe të perealizuar, janë kushtet bazë të një hapësire të re, bazuar në konceptin e vlerës potenciale si qëllim ruajtjeje dhe jo vetëm si një fazë përgatitore e të sotmes. Qëllimi i kësaj ekspozite është që të zhvillojë një pikë të re të mendimit përsa i përket arkitekturës urbane në qytetet shqiptare.

Adrian Paci prezanton video-instalacionin “Kolona”, një përrallë vizionare që flet për delokalizimin e punës, transformimin e traditave dhe ballafaqimin mes kulturave, një metaforë e fuqishme vizuale dhe bukuri enigmatike.

Edi Hila prezanton “Penthouse” (Shtesat) – cikli i tablove që sjellin një vështrim në urbanistikën “postmoderne” shqiptare. Në veprat e Hilës tregohen pallate të larta, nga ato që kanë mbirë kudo në Tiranë, mbi tarracat e të cilëve janë ndërtuar apartamente shtesë. Edi Hila është marrë pikërisht me këto “ndërtime të paligjshme”, sipas terminologjisë lokale, për t’i sjellë në tablo si krijesa që tregojnë një aspekt dominues të problematikës sociale dhe arkitekturore me të cilën janë përballur qytetet tona këto vite.

Ministria e Kulturës së Shqipërisë pas konsultave me kolegë, e ekspertë të njohur, arkitektë, artistë e teoricienë, brenda e jashtë Shqipërisë, duke e marrë seriozisht realizimin e këtij projekti, edhe në sajë të rekomandimeve të ekspertëve të Beyond Entropy Europe, thekson fort se është angazhimi ynë që Shqipëria të marrë pjesë vazhdimisht e në mënyrë të rregullt në evenimente të rëndësishme ndërkombëtare të artit e kulturës si Bienalja e Venecias, e jo në mënyrë fragmentare siç ka ndodhur deri më sot. Kjo na bëri ta shihnim pjesëmarrjen në këtë edicion të Bienales së Arkitekturës në Venecia si një domosdoshmëri, për të filluar një rrugë të re të konceptimit dhe prezantimit të Shqipërisë. Hapja e këtij aktiviteti madhor në arenën ndërkombëtare të artit dhe arkitekturës, zhvillohet në prag të marrjes së statusit të vendit kandidat të Shqipërisë. Jemi të bindur se përfaqësimi dinjitoz i vendit tonë në aktivitete kulturore të nivelit të Bienales së Venecias, ka luajtur dhe do të vazhdojë të luajë një rol mjaft të rëndësishëm në integrimin e Shqipërisë në Evropë. E kemi shprehur këtë edhe në raste të tjera, siç qe ardhja e koreografit me famë botërore, Angelin Preljocaj, në Tiranë, dhe do të vazhdojmë ta themi me bindje edhe në të ardhmen.

Nënvizojmë faktin se :

Ka një interesim të dukshëm për pavijonin shqiptar nga median ndërkombëtar, ende pa u hapur pavijoni 3 revista profesioniste të njohura kanë shkruar për pavijonin shqiptar.

Ky pavijoni hapet në një nga hapësirat më të rëndësishme të Bienales, siç është Arsenale, që ka numrin më të lartë të vizitorëve.

Në hapjen e pavijonit shqiptar do të marrë pjesë kryeministri Edi Rama dhe personalitete të shquara të arkitekturës, artit dhe medias ndërkombëtare.

Në vijim të Bienales MK dhe B/E do të organizojnë në Tiranë prezantim të aktivitetit të Bienales dhe konferenca debati me grupe të ndryshme interesi rreth temës së Pavijonit Shqiptar, përgjatë gjashtë muajve.

MEDIA

ATRIBUNE: <http://bit.ly/min-kult-atribune-article>

EXIBART: <http://bit.ly/min-kult-exibart--article>

MYARTSGUIDE: <http://bit.ly/min-kult-myartguides-article>

MAPO: <http://bit.ly/min-kult-mapo-article>

PANORAMA: <http://bit.ly/1jWQ8Dm>

Të dhëna mbi artistët, kuratorët, mbështetësit dhe bashkëpunorët:

Edi Hila ka lindur në Shkodër në vitin 1944. Ka marrë pjesë në shumë ekspozita ndërkombëtare, mes të cilave Bienale e Venecias (1999), "After the Wall" në Muzeun Modern Stokholm (1999), në muzeun Hamburger Bahnhof të Berlinit, në muzeun Ludwig të Budapestit (2000), "Blood and Honey - Future's in the Balkans" në muzeun Essl të Vienës (2003), dhe në Bienalen e Liverpoolit (2010). Veprat e tij bëjnë pjesë në koleksione të Qendrës Pompidou, Ville de Paris, René Block dhe në Galerinë Kombëtare të Arteve, Tiranë.

Adrian Paci ka lindur në Shkodër, Shqipëri në vitin 1969. Ka marrë pjesë në shumë ekspozita ndërkombëtare. Disa nga ekspozitat e tij personale më të rëndësishme mund të përmendim: "Adrian Paci" PS1, MOMA, New York (2005); "Motion Picture(s)", Kunsthaus Zurich (2010); "Lives in transit", Jeu de Paume, Paris (2013); MAC, Musée d'art contemporain de Montréal, Montréal (2014). Ekspozita kolektive: Bienale e Venecias (2005); "Street and studio in urban history of photography"; Tate Modern, Londër (2008); "Unfinished Journeys", National Museum of Arts, Oslo (2012); dhe "Neighbours", Istanbul Museum of Modern Art, Istanbul (2014).

Beyond Entropy është një agjenci kërkimi në arkitekturë, urbanizëm dhe në fushën e analizave kulturore, që përdor konceptin e energjisë si një mjet për të hartuar forma të reja të arkitekturës përtej retorikës së qëndrueshmërisë. **Beyond Entropy** operon globalisht në tri hapësira të rëndësishme: Afrikë, Mesdhe dhe Evropë.

Pavijoni shqiptar është mbështetur nga:

ACACIA – Associazione Amici Arte Contemporanea

Martina Fiocchi

Andrea Fustinoni & Fabio D'Amato

Marianne & Tobias Guldemann

Andrea & Thomas Hürlimann

nctm e l'arte

Filippo & Alessandra Orsi Mangelli Alverá

Giovanni Sardagna

Matteo Viglietta S.p.A.

Falenderojmë për mbështetjen e tyre galeritë:

kaufmann repetto, Milano, NewYork

Peter Kilchmann, Zurich

Potential Monuments of Unrealised Futures
Monumente të Mundshëm Ardhmërisht të Perealizuara

Artistë: Ardian Paci, Edi Hila

Mbikqyrës: Ministria e Kulturës së Shqipërisë

Kurator: Beyond Entropy Europe (Jonida Turani, Stefano Rabolli Pansera)

Ass/Kuratorë: Doyeon Cho, Marina La Verghetta

Graphic designers: Tankboys

Kohëzgjatja: 7 Qershor- 23 Nëntor 2014

Salla: Armi, Arsenale di Venezia

Hapja dhe Press Konferencë: 6 Qershor 2014 , ora 15.00-17.00

Milena Selimi

Marrdhëniet me Publikun dhe Mediat

Ministria e Kulturës

Rr. Kavajes Nr 1, 1003 Tiranë

Tel.: 068 20 14 441; 067 60 72 401

e-mail: milena.selimi@kultura.gov.al

Giovanna Tissi & Valeria Frisolone

giovannatissi@beyondentropy.com

+ 39 347 7971873

v.frisolone@beyondentropy.com

+ 39 334 3523916